



AKZM
AGJENCIA KOMBËTARE
E ZONAVE TË MBROJTURA

05/08/2021

NJOFTIM PËR PUNËSIM

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me **Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura Shkoder**, fillojnë zbatimin e projektit **“Punë për komunitetin”**. Projekti synon kontrollin e erozionit nepermjet pyllzimeve ne zonat mbrojtura te “Përroit të Thatë, Parkut Kombëtar të Dajtit, Korab Koritnik dhe Parkut Kombëtar të Butrintit“ si dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe sociale në komunitetet përkatëse, duke patur parasysh nivelin e papunësisë së shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Ky projekt do të zgjasë 3 muaj dhe mbështetet nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) nëpërmjet GIZ në Shqipëri. Për gjatë 3 muajve projekti do të punësojë një numër përfituesish në komunitet, të cilët do të punojnë kryesisht për mbjelljen e vegjetacionit në territoret e zonave të mbrojtura.

Nëse jeni të interesuar të ndihmoni komunitetin dhe vendbanimet tuaja, kundrejt një page mujore, ju lutemi të paraqiteni pranë zyrave tona (AdZM Shkoder) në , në datë **18.8. 2021**, duke patur me vete një kopje të kartës së identitetit, adresën e banesës tuaj, numrin e llogarisë bankare dhe një numër kontakti.

Projekti inkurajon aplikimet nga grupet në nevojë dhe të grave nga këto komunitete.

Person Kontaktit: Agim Dardha Drejtor AdZM Shkoder

Ju mirëpresim!

Punë për Komunitetin